



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:254916  
Datë: 09.10.2024  
Numri i dokumentit: 06272543

Ac.nr.2584/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Nehat Idrizi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses S.S nga N....., të cilën e përfaqëson me autorizim M.N, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës MPB - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1625/2021, të datës 27.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.10.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës MPB - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, MPB - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, në pikën I dhe III të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1625/2021, të datës 27.02.2023, ka vendosur si në vijim: “ I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.R nga Gj....., dhe DETYROHET e paditura Policia e Kosovës, Rruga “Luan Haradinaj”, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të shpërblimit të pagave të rregullta mujore t’ia paguajë shumën në vlerë prej 1,531.86,( njëmijë e pesëqind e tridhjetë e një euro e tetëdhjetë e gjashtë

cent) për shkak të vlerësimit të kënaqshëm në punë dhe mungesës së masave disiplinore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë (10.11.2021), e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. II. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit për shujtë ditore, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, t'ia paguajë paditësest shumën prej 944 € e llogaritur nga 2.00 euro në ditë, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 10.11.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive. III. DETYROHET e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën prej 134€, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, përmes të autorizuarës së saj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës jokontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe ta prishë aktgjykimin si të pabazuar me ligj.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të tij, me datën 10.11.2021 pranë gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës me objekt të kontestit kompensimi i pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, përmes së cilës ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditëses, në emër të shujtës ditore nga data 14.11.2018 e deri me datë 31.12.2020, për 472 ditë pune t'ia paguaj nga dy euro në ditë shumën prej 944 €, ndërsa, në emër të shpërbllimit të pagave të rregullta mujore në fund të vitit 2018, 2019, 2020 t'ia paguajë shumën në vlerë prej 1,531.86 €, për shkak të vlerësimit të kënaqshëm në punë dhe mungesës së masave disiplinore për vitet e lartcekura, të gjitha me kamatëvonesë vjetore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës edhe atë 104 €, për përpilimin e padisë dhe 20 €, për taksë gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 8 e lidhur me nenin 152 të LPK-së, pa shqyrtim kryesor të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1625/2021, të datës 27.02.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të themeltë kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar te e paditura, pasi kjo vërtetohet nga fakti se paditësja

është e punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës nga data 15.04.2013 (vërtetimi nr. Ref.04/01 06/SRR/501/2021 i datës 26.04.2021 dhe për vitet 2018, 2019 dhe 2020 është vlerësuar me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm (formulari i vlerësimit të performancave për këto 3 vite), si dhe Kontrata pune për kohë të pacaktuar me nr.ref.07/1-01R/181/2013 të dt.06.12.2012, gjykata ka vërtetuar se paditësja është e punësuar në kohë të pacaktuar.

Tutje gjykata e shkallës së parë ka shtuar se e paditura ka pasur detyrim që paditëses si e punësuar e saj t'ia paguaj pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi janë plotësuar kushtet nga ana e paditëses si parashihen me nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018, me saktësisht, vlerësimi i performancës për vitet 2018, 2019 dhe 2020, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Vendimin e ka bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 date 19.06.2012/, ku shprehimisht është përcaktuar se „Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit, 452 paragrafi 3 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sa i përket pretendimit ankimor se kërkesëpadia e paditësve është parashkruar, kjo gjykatë vlerësoi se një pretendim të tillë e paditura nuk e ka parashtruar gjatë përgjigjes në padi të cilën gjykata e shkallës së parë e kishte ftuar që të paraqesë andaj meqenëse kjo nuk e ka paraqitur përgjigjen në padi tani një pretendim i tillë nuk mund të paraqitet në ankesë, ngase sipas nenit 180.3 të LPK-së, parashihet se *“Prapësimi i parashkrimit dhe prapësim me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*, andaj një pretendim i tillë është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Në raport me pretendimin për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike po ashtu kjo nuk qëndron sepse nga provat e administruara dhe vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë vërtetuar këto fakte: punësimi i paditësve të e paditura, vlerësimi pozitiv i paditësës nga e paditura për vitet 2018, 2019 dhe 2020 dhe mungesa e shqiptimit të ndonjë masë në procedurë disiplinore, lartësia e pagave është vërtetuar me dokument zyrtar siç është lista e pagave dhe është bazuar në pagën e muajit dhjetor për vitet kontestuese (ku në bazë të listave të pagave vërtetohet se shuma e përgjithshme për katër vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 është shuma si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar), e paditura nuk ka arritur të provojë se ia ka kompensuar paditësve pagat e kërkuara.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e procedurës nga neni 78 dhe 79 i Ligjit të Punës, pasi kërkesa e paditësës nuk hyn në kategorinë e çështjeve për tu ngritur konform neni 78 fillimisht të e paditura e më pastaj konform neni 79 në gjykatë, për arsye se nga ana e punëdhënësit nuk ka ndonjë vendim paraprak të cilin do ta godiste paditësen, por ka detyrim të përmbushjes nga ana e të paditurës.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës dhe atë me nenin 29.1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2. përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Paditësit i plotësojnë kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që janë në marrëdhënie pune të e paditura, nuk kanë pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitet kontestueses, 2018, 2019 dhe 2020, ndërsa ka pasur vlerësim të mirë për këto vite, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të listat e pagave për vitet, 2018, 2019 dhe 2020 si dokument publik lëshuar nga e paditura, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Lidhur me kamatën është vendosur konform neni 382 paragrafi të LMD-së, ku përcaktohet lartësia prej 8% në vit, ndërsa e njëjta fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë pasi bëhet fjalë për dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e 449 dhe 452 të LPK-së.

Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2584/2023, me datë 07.10.2024

Kryetari i kolegjit  
Qerim Ademaj, d.v